

20161894165

LIGJ PËR PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR EKONOMI TË UJËRAVE

Neni 1

Në Ligjin për ekonomi të ujërave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 51/15 dhe 193/15), në nenin 6 pas paragrafit (5) shtohet paragraf i ri (6), si vijon:

"(6) Me përjashtim nga paragrafi 1 i këtij neni, SHA Ekonomia e Ujërave për kryerje të shërbimeve për ujitje të sipërfaqeve bujqësore nëpërmjet shfrytëzimit të sistemeve për ujitje në pronësi të Republikës së Maqedonisë, e me të cilën ekonomizon shoqëria aksionare, mund të lidhë marrëveshje me kooperativa bujqësore për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e tyre, vetëm në rast se:

- për rajonin e përfshirjes për të cilën është formuar kooperativa bujqësore nuk ka degë ndërsa është në rajonin e veprimit të shoqërisë aksionare ose

- shoqëria aksionare ka degë dhe është në rajonin e veprimit të saj, por ka lidhur Marrëveshje për sigurim të mjeteve financiare në bazë të Projektit për përmirësim të ujitjes dhe zhvillim të sistemit të infrastrukturës për ujitje i cili është i financuar nga organizata ndërkombëtare financiare, e sipas të cilit shfrytëzues përfundimtar i sistemit duhet të jetë kooperativa bujqësore".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".